

UDHËZUES

i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale për të monitoruar zbatimin e standardeve të raportimit për rastet e dhunës me bazë gjinore në media

INSTRUMENT HORIZONTAL
PËR BALLKANIN PERËNDIMOR DHE TURQINË 2019-2022



Përgatitur nga:
Prof. dr. Katarine Sarikakis
Ekspert i Këshillit të Evropës

Liria e shprehjes dhe
liria e mediave

<http://horizontal-facility-eu.coe.int>

Financuar
Nga Unioni Evropian dhe
Këshilli i Evropës



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implementuar
Nga Këshilli i Evropës

Udhëzues i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale për të monitoruar zbatimin e standardeve të raportimit për rastet e dhunës me bazë gjinore në media

Instrument horizontal për Ballkanin perëndimor 2019-2022

Projekt „Liria e shprehjes dhe liria e mediave në Maqedoninë Veriore“

Ky publikim është bërë me mbështetje financiare nga Unioni Evropian dhe Këshillit të Evropës. Qëndrimet e shprehura këtu nuk pasqyrojnë domosdomshëmrisht qëndrimet e njëjës prej këtyre dy organizatave.

Riprodhimi i fragmenteve (deri më 500 fjalë) është i lejuar, përveç rasteve kur është për qëllime komerciale, për sa kohë që kujdeset për të ruajtur integritetin e tekstit, fragmenti të mos përdoret jashtë kontekstit, për të dhënë informacion jo të plotë ose që të çoj lexuesin në drejtim të gabuar për sa i përket natyrës dhe shtrirjes dhe përmbajtjes së tekstit. „© Këshilli i Evropës, viti I botimit“. Të gjitha kërkesat lidhur me riprodhimin / e të tërë ose një pjesë të dokumentit duhet t'i drejtohen Drejtorisë së komunikimeve, Këshilli i Evropës (Directorate of Communications, Council of Europe, F-67075 Strasbourg Cedex или publishing@coe.int).

Foto e kopertinës/ballinës: Shutterstock

© Këshilli I Evropës, qershor 2021. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Këshilli Evropian ka të drejtë ta përdorë në kushte të caktuara.

SHKURTESAT

| | |
|---------------|--|
| <i>DSHMA</i> | <i>Direktiva për shërbimet e medias audiovizuale</i> |
| <i>KE</i> | <i>Këshilli Evropian</i> |
| <i>EU</i> | <i>Unioni Evropian</i> |
| <i>FNG</i> | <i>Federata ndërkombëtare e gazetarëve</i> |
| <i>OSBE</i> | <i>Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Evropë</i> |
| <i>ADTH</i> | <i>Agjencia për të drejtat themelore</i> |
| <i>PDHBGJ</i> | <i>Dhuna me bazë gjinore</i> |
| <i>OBSH</i> | <i>Organizata botërore e shëndetësisë</i> |

Tabelat

| | |
|---|----|
| Tabelat 1: Parimet e pranuarë përgjithësisht të vetërregullimit | 13 |
| Tabela 2: Objektivat rregullative të pranuarë përgjithësisht në raportimin e medias..... | 20 |
| Tabela 3: Praktika të këqija të përgjithësuara të vazhdueshme në media kur raportohet për dhunën ndaj grave | 21 |
| Tabela 4: Parimet e pranuarë përgjithësisht të praktikës së mirë mediatike në raportimin e KPZH-së..... | 26 |

Përmbajtja

| | |
|--|----|
| Shkurtesa | 3 |
| Tabelat..... | 4 |
| 1. Hyrje..... | 7 |
| 2. Objektivat rregullatore..... | 8 |
| 3. Vështrim I dispozitave rregullatore përkatëse..... | 9 |
| 3.1. Hyrje..... | 9 |
| 3.2. Vetërregullimi..... | 11 |
| 3.2.1. Vetërregullimi I gazetarëve: parimet e përgjithshme..... | 11 |
| 3.2.2. II. Vetërregullimi I gazetarisë online..... | 12 |
| 3.2.3.III. Vetërregullimi që përmbahet tek etika globale gazetareske..... | 13 |
| 3.3. Dispozitat rregullatore..... | 13 |
| 3.3.1. Ligji i Bashkimit Evropian..... | 13 |
| 3.3.2. Karta e të drejtave themelore të BE-së..... | 15 |
| 3.3.3. Konventa për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore-EKPC 1950..... | 15 |
| 3.3.4. Konventa për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës familjare(Konventa e Stambollit)..... | 16 |
| 3.3.5. Ligji për shërbimet mediatike audio dhe audiovizuale..... | 18 |
| 3.3.6. Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhunës në familje..... | 19 |
| 4.KARAKTERISTIKAT E MONITORIMIT..... | 20 |
| 4.1 Hyrje..... | 20 |
| 4.2 Rekomandim se si t’l qasemi procesit të monitorimit..... | 21 |
| 4.2.1. Shqyrtimi preliminarë i stories..... | 21 |
| 4.2.2. Pyetje gjenerike të synuara..... | 22 |
| 4.2.3. Pyetje gjenerike në kontekstin e stories/subjektit..... | 22 |
| 4.2.4. Pyetje konkrete për përmbajtjen e stories/subjektit..... | 23 |
| 4.2.5 Mjete konkrete komunikimi në raportim..... | 24 |
| 5. PRAKTIKA TË MIRA NË RAPORTIM..... | 25 |
| 6. KOMENTE..... | 27 |
| 7. FJALORTH..... | 28 |
| 8. BIBLIOGRAFIA..... | 28 |

1. HYRJE

Qëllimi dhe funksioni i kësaj pakete udhëzuese për monitorimin e rregullatorit të medias është të ofrojë standarde dhe kritere të qarta që synojnë vlerësimin e një përmbajtjeje të caktuar kur raportohet për dhunën me bazë gjinore. Qëllimi është të sigurohet transparence dhe qartësi në zhvillimin e një mënyre përmes së cilës mund të bëhet standardizimi i vlerësimit. Kategoritë e dhunës, si dhe shembujt, nuk janë shteruese, por paraqesin disa tregues kyç në përputhje me instrumentet mbështetëse ndërkombëtare si ato të UNESCO-s, BE-së dhe të tjera që transmetojnë të njëjtat parime kyçe të rregullimit në luftën kundër dhunës me bazë gjinore.

Udhëzuesi është i organizuar siç vijon: përcaktimi i objektivave rregullatore, dhe parimeve gjithëpërfshirëse si bazë e Udhëzuesit; duke përcaktuar arsyen e nevojës për këtë udhëzues; dhe shpjegimi i kritereve të vlerësimit të përmbajtjes përmes pyetjeve kryesore që duhen të përgjigjen, përkatësisht të përcaktuara nga rregullatori. Pyetjet janë bazuar në parimet rregullatore (domethënë synimi i dispozitave ligjore dhe politike) dhe dispozitat e veçanta siç përshkruhen në dokumente të veçanta ligjore. Së fundi, dokumenti ofron udhëzime mbi praktikën e mira të dëshiruara si një kontrast midis tekstit konkret në çdo kohë dhe cilësisë së raportimit të kërkuar nga rregullatori, në përputhje me standardet e praktikave të mira dhe rregulloren me në qendër të drejtat e njeriut.

Udhëzuesi bazohet reflektim dhe diskutime në seminare mbi mënyrat për të monitoruar në mënyrë efektive rolin e medias në parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave. Ekspertja e Këshillit të Evropës, Katarine Sarikakis kryesoi dhe moderoi Punëtorinë për organin rregullator të medias dhe organin vetërregullues të etikës mediatike për rregullim, vetërregullimin dhe monitorimin e zbatimit të standardeve të raportimit në rastet e dhunës në media me bazë gjinore. Puna përbëhej nga gjashtë pjesë:

1. Konteksti i dhunës me bazë gjinore (DHBGJ) dhe dhunës ndaj grave;
2. Thyerja e miteve dhe ekzaminim i terminologjisë së saktë;
3. Instrumentet kombëtare dhe globale në trajtimin e DHBGJ;
4. Roli i mediave në parandalimin e dhunës dhe roli i tyre në forcimin e bazës kulturore në normalizimin e dhunës;
5. Fushat dhe mjetet për raportim senzitiv mbi DHBGJ dhe etikën raportimit;
6. Mjetet dhe çështjet kyçe në monitorimin e standardeve etike dhe zbatimin e tyre në raportimin mediatik.

Gjatë sesioneve të punëtorisë u ndanë përvoja dhe diskutime konkrete lidhur me Maqedoninë e Veriut në krahasim me vendet e tjera Evropiane.

Përveç kësaj, është e rëndësishme të theksohet konteksti lidhur me numrin aktual të viktimave dhe të mbijetuarve të abuzuar si dhe gjendjen e grave në Evropë që kanë përjetuar dhunë. Dhuna ndaj grave është akoma një nga pengesat kryesore në arritjen e barazisë gjinore dhe është shkelje e të drejtave të njeriut.

Në nivel Evropian, një në pesë gra përjetojnë dhunë me partnerin intim, ndërsa një në katër gra është e sulmuar me një rezultat jo fatal; një në dy abuzohet seksualisht në BE28; ndërsa një në pesë gra ishte objektivi i ndjekjes sipas një studimi për të Agjencisë për të drejtat themelore (ADTH 2014).

Përveç kësaj, të paktën 5400 gra të moshës nga 15 deri 49 vjeç në rajonin Evropian të OBSH-së humbën jetën si rezultat i DHBGJ-së; dy nga pesë gra ishin të vrarë nga partnerët e tyre actual ose të mëparshëm (OBSH, 2017).

Statistikat në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë gjithashtu shqetësuese: raporti i OSBE-së i vitit 2018 tregoi se 14% e grave kanë përjetuar dhunë që nga mosha 15 vjeçare¹; 44% e grave përjetuan dhunë psikologjike; 30% e grave janë abuzuar seksualisht që nga mosha 15 vjeçare. Megjithatë, këto shifra duhet të merrem me kujdes pasi ka të ngjarë të pasqyrojnë paragjykimet kulturore ndaj pretendimeve të grave dhe rolit të gruas në shoqëri. Si fillim, me rëndësi është të kuptohet kjo dhe të vlerësohet se këto shifra pasqyrojnë shfaqjen e rasteve më pak të raportuara, që dë të thëtë se DHBGJ-ja është më e përhapur.

Për më tepër, ekziston nevoja për të përdorur terminologjinë e duhur që duhet të jetë në përputhje me Konventën për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, e njohur si Konventa e Stambollit², dhe për të identifikuar format dhe shprehjet e ndryshme të dhunës. Kjo përfshin jo vetëm dhunën fizike dhe të dukshme, por edhe forma të tjera si dhuna psikologjike, gjuhë e urrejtjes dhe ndjekja. Në veçanti kur bëhet fjalë për mediat dhe komunikimet, nocionet e dhunës dhe trajtimi i tyre duhet t'i marrë parasysh të gjitha ato forma.

2. Objektivat rregullatore

Rritja e vëmendjes ndaj burimeve, proceseve dhe ndikimit të diskriminimit gjinor si një fenomen kulturor, social, politik dhe ekonomik po shkakton reagime të rëndësishme rregullatore në nivel global. Si pjesë e një qasjeje gjithëpërfshirëse për të luftuar dhunën me bazë gjinore ndaj grave, mediat janë identifikuar si një nga aktorët kryesorë në rolin e tyre të mundshëm në parandalimin e dhunës ndaj grave, si dhe në rolin e tyre në edukimin dhe ndërgjegjësimin. Përveç kësaj, ato shihen njëkohësisht si burime të përforcimit kulturor të qëndrimeve diskriminuese dhe të dëmshme ndaj grave përmes raportimeve të papërgjegjshme ose seksiste. Lufta kundër dhunës me bazë gjinore ndaj grave është një detyrë që duhet të ndërmerret nëpër shumë sektorë dhe politika.

Prandaj, kur bëhet fjalë për masat në fushën specifike të rregullimit të medias, iniciativat e politikave përfshijnë:

- a. politika të buta me fokus të veçantë mbi rregullimin dhe etikën të hartuara dhe të harmonizuara nga palët përkatëse të intereseit, dhe
- b. dispozitat rregullatore të integruara në legjislacionin kombëtar dhe të harmonizuara me ligjet dhe marrëveshjet evropiane dhe ndërkombëtare.

Këto dy forma të politikave kanë për qëllim të ofrojnë qasje të shumëanëshme, veçanërisht në rregullimin e përmbajtjes, të cilat paraqesin garancinë e lirisë së shprehjes të mbrojtur nga instrumentet ndërkombëtare dhe legjislacioni kombëtar. Prandaj, është shumë e rëndësishme që të merren parasysh të dy dimensionet politike, për të monitoruar përmbajtjen e informacionit dhe raportimin, mbi gjitha edukimin social të aktorëve të përfshirë në prodhimin e lajmeve dhe shpërndarjen e informacionit në lidhje me dhunën me bazë gjinore ndaj grave.

¹ OSBE, 2019 год.

² Këshilli i Evropës, 2011 год.

Përveç çështjeve të përafrimit strukturor me qëllimet e Konventës së Stambollit, është thelbësore të njihet dhe të ndihmohet ndryshimi i qëndrimeve dhe praktikave në lidhje me „krijuesit e kuptimit“ në shoqëritë tona, mediat në të gjitha format e tyre. Roli i fushave kulturore dhe simbolike të gjuhës, përfaqësimit dhe debatit forcon, legjitimon, normalizon dhe justifikon pikëpamjet seksiste të grave. Bota simbolike e krijimit të kuptimit ndërvepron vazhdimisht me botën fizike dhe strukturore: idetë dhe normat që janë dominuese dhe të pranuar në një shoqëri krijojnë terren për forma fizike dhe psikologjike të dhunës. Mediat dhe institucionet kulturore janë shtytësit e ideve dhe debateve në shoqëritë tona. Kështu, qëllimi i ndryshimit shoqëror në përputhje me mbrojtjen e të drejtave të njeriut duhet të nënkuptojë një focus në të gjitha format.

Objektivat e përbashkëta rregullatore të së drejtës evropiane dhe ndërkombëtare në fuqinë e luftimit të dhunës ndaj grave mund të përshkruhen si në vijim:

- Parandalimi i diskriminimit dhe dhunës ndaj grave dhe vajzave,
- Mbrojtja e grave nga dhuna,
- Sfidimi i stereotipeve që theksojnë normalizimin kulturor të dhunës ndaj grave,
- Promovimi i të kuptuarit dhe forcimi i ndërgjegjësimit se dhuna ndaj grave është shkeleje e të drejtave të njeriut të grave,
- Parandalimi i viktimizimit sekundar,
- Mbrojtja nga diskriminimi,
- Ndjekja e politikave për të luftuar dhunën ndaj grave nëpërmjet politikave të integruara në përputhje me Konventën e Stambollit.

Kështu, synimet rregullatore të mosdiskriminimit, parandalimit dhe mbrojtjes nga dhuna gjithashtu duhet të *përmushen* në nivelin kulturor dhe strukturor të shoqërisë. Raportimi i medias është pjesë përbërëse e „ndërtimit“ të mirëkuptimeve kulturore për gratë dhe DHBGJ, si dhe roli i promovimit të rëndësisë strukturore dhe institucionale në lidhje me politikat e DHBGJ-së (jo vetëm ratstatet e dhunës, por edhe reagimi i institucioneve si policia, gjykata, shteti etj.). Funkzioni parandalues i medias si edukatorë dhe „narratorë“, kulturorë, si dhe roli i tyre në mbrojtjen nga dhuna duke ndihmuar në ndërgjegjësimin përmes raportimit të sensibilizuar dhe etik, janë parimet mbi të cilat mbështetet subjekti i këtij Udhëzuesi monitories.

3. VËSHTRIMI I DIPOZITAVE PËRKATËSE RREGULLATIVE

3.1. Hyrje

Qëllimi i kësaj pjese është të ofrojë një pasqyrë të shkurtër por gjithëpërfshirëse të mjedisit rregullator që lidhet me raportimin për dhunën me bazë gjinore.

Ekzistojnë dy dimensione të rëndësishme për këtë proces: e para, aspektet vetërregulluese janë të rëndësishme sepse ato janë pjesë e sistemit të qeverisjes së medias në një kontekst kombëtar (dhe ndërkombëtar) dhe konsiderohen si pjesë e rregullimit të medias demokratike bazuar në llogaridhënie dhe transparence. Vetërregullimi nuk konsiderohet si një çështje zgjedhjeje, por si një respektim i detyrueshëm i rregullave të pranuar përgjithësisht nga profesionistët, dmth gazetarë dhe organe të medias për të raportuar kudo dhe në çdo media.

E dyta, dispozitat rregullatore përbëhen nga kërkesat teknike si dhe nga qëllimi i ligjvënësit dhe fryma e politikës. Prandaj, edhe pse paragrafët rregullator që lidhen me rolin e medias mund të gjenden në disa vende në DSHMA, Konventën e Stambollit dhe ligjin kombëtar, dispozitat këtu i referohen poashtu

mjedisit në të cilin media thirret të funksionojë, pra fryma të legjislacionit përkatës. Prandaj, kjo do të thotë që kur merren vendime për harmonizimin e përmbajtjes mediatike me standardet e pritshme të komunitetit dhe politikave, kriteret e kërkuara mund të gjenden jo vetë në aspektet teknike të ligjit, por edhe në thelbin dhe qëllimin e ligjit dhe politikës relevante.

Kështu, megjithëse është e qartë se mediat konsiderohen partnerë të rëndësishëm në luftën kundër dhunës ndaj grave, është e nevojshme të përfshihen parimet dhe mjetet konceptuale ligjore mbi të cilat bazohet Konventa e Stambollit si dokumenti ligjor më gjithëpërfshirës aktualisht në raportim dhe sistem i monitorimit. Mjedisi më i gjërë kulturor. Politik, social dhe ekonomik në të cilin bëhet raportimi duhet të lidhet plotësisht me artikujt e analizuar nga rregullatori. Prandaj, konteksti më i gjërë rregullator i parimeve ofron një kod të gjërë dhe transparent sipas të cilit mund të bëhet një vlerësim i besueshëm i raportimit.

Përvoja e qasjeve kombëtare nëpër Evropë tregon disa tendenca që ia vlen të përmenden. Në nivel global, 155 vende kanë miratuar ligje kundër DHBGJ-së. Në rajonin e Evropës, Këshilli I Evropës ka zhvilluar standarde për gjuhën e urrejtjes seksiste, siç është Rekomandimi CM/Rec (2013)³ për barazin gjinore dhe mediat; CM/Rec (2016)⁴ për mbrojtjen e gazetarisë dhe sigurinë e gazetarëve; Strategjia e e qeverisjes së internetit CM (2016)⁵ e cila kërkon aktivitete monitoruese; Strategjia për të drejtat e fëmijës 2016 – 2021⁶ ku prioriteti kryesor është jeta pa dhunë. Poashtu, Komisioni Evropian për here të parë përfshinë fjalimin seksist si gjuhë urrejtjeje në Rekomandimin e politikave të përgjithshme nr. 13 të 2015³-ës për të luftuar gjuhën e urrejtjes. Përfundimisht, DSHMA dhe neni 6 lejojnë ndalimin e përmbajtjes që shkel ligjet e diskriminimit, përfshirë në bazë të seksit.

Pavarësisht përpjekjeve të shtuara dhe të dhe të ndërgjegjshme në nivel politikash, vëzhguesit argumentojnë se legjislacioni në nivel të BE-së është ende i pakënaqëshëm. Sidoqoftë, duhet të theksohen disa tendenca:

- Legjislacioni për dhunën ndaj grave është miratuar *në disa fusha*, e drejta e shtëpisë dhe e familjes; ligji për punësim; dispozitat e barazisë;
- *Asnjë rregullore* për mediat nuk e përfshinte në mënyrë konkrete DHBGJ-në;
- Ekziston rregullore evropiane lidhur me gjuhën e urrejtjes por zbatohet në mënyrë të jo të barabartë. *Të folurit seksist* aktualisht është e pranuar nga gjykata gjermane si një moment i ri;
- *Vetërregullimi* në formën e mjeteve dhe kodeve të sjelljes është në rritje. Gazetarët dhe shoqatat profesionale gazetareske dhe këshillat e etikës mediatike krijojnë mjete që rrjedhin nga organizatat ndërkombëtare dhe kodet e sjelljes;
- Forcohen *trajnimet* dhe zhvillimi i sistemeve të monitorimeve, siç janë funksionet e avokatit të Popullit;
- Nënshkruhen bashkëpunime dhe projekte horizontale.

3 CoE CM 2013

4 CoE CM 2016a

5 CoE CM 2016b

6 CoE 2016c

7 CoE 2016

3.2. Vetërregullimi

Kodi i gazetarëve³ paraqet kornizën morale Brenda të cilit pritet të punojnë gazetarët në vend. Nga gazetarët pritet të respektojnë Kodin si dhe paketën e Udhëzimeve për raportim etik të mediave online, që prek në mënyrë konkrete tendencat e gazetarisë online. Përveç kësaj, Këshilli i etikës në vend I përmbahet kodit të etikës të Federatës Ndërkombëtare të Gazetarëve.

Më poshtë janë rregullat që përcaktojnë sesi gazetarët duhet të punojnë dhe të japin kulturën e pritur dhe të kërkuar gazetareskë në një vend demokratik.

3.2.1. Vetërregullimi i gazetarëve: parimet e përgjithshme

Në përputhje me Deklaratën e Parimeve në Kodin e Gazetarëve, Këshilli për Etikë në media në Republikën e Maqedonisë së Veriut citon:

„Duke ndjekur rolin e vet në ndërtimin e demokracisë dhe shoqërisë civile, gazetarët do të mbrojnë të drejtat e njeriut, dinjitetin dhe lirinë, do të rrespektojnë pluralizmin e ideve dhe qëndrimeve, do të kontribuojnë në forcimin e shtetit juridik dhe në kontrollin e qeverisë dhe të subjekteve tjera nga jeta publike.“

Paragrafët në vijim udhëzojnë në çështjet konkrete që lidhen me të drejtat dhe dinjitetin e njeriut, raportimin e balancuar dhe jostereotipe, çështjet që lidhen me dhunën dhe mbrojtjen e individëve të cenueshëm si fëmijët, dhe çështjet që lidhen me gjuhën e urrejtjes:

“Paragrafet“

5. *Gazetari do t’u bindet ligjeve të vendit, por nuk do të publikojë apo fshehë asgjë që është kundër interesit publik.*
10. *Gazetari nuk do të krijojë apo përpunojë me vetëdije informacione që rrezikojnë të drejtat ose liritë e njeriut, nuk do të flasë me gjuhën e urrejtjes dhe nuk do të nxisë dhunë dhe diskriminim mbi asnjë bazë (nacionale, fetare, racore, gjinore, sociale, gjuhësore, orientimi seksual, politik...).*
11. *Gazetari do t’u përmbahet standardeve të pranuarra përgjithësisht shoqërore të mirësjelljes dhe respektit për diversitetin etnik, kulturor dhe fetar në Maqedoni.*

³ Kodi i gazetarëve, <https://znm.org.mk/en/code-of-ethics-of-journalists/>

3.2.2 II. Vetërregullimi i gazetarisë online

Sipas udhëzimeve për raportim etik të mediave online (që paraqet përmirësim shtesë dhe përmban shpjegime të dispozitave të Kodit të Gazetarëve në sferën online) të Këshillit për Etikën Mediatike në Maqedoni:

Neni 7

7.1. *Temat që lidhen me tragjeditë personale do të trajtohen gjithmonë me kujdes, kurse ata që preken nga tragjedia do t'ju afrohen me ngushllim dhe diskrecion. Nuk do të publikohen emra apo fotografi të viktimave kur raportohen aksidente, krime, vetëvrasje apo dhunë në familje. Nuk do të publikohen të dhëna nga të cilat në mënyrë indirekte do të mund të zbulohej identiteti i viktimës apo autorit, para se të shpallet zyrtarisht nga institucionet kompetente. Emra dhe fotografi të personave të zhdukur do të publikohen vetëm me lejen e të afërmeve apo organave të përfshiar në kërkimin e personit të zhdukur.*

7.3. *Në raportimin e viktimave të përdhunimit ose viktimave të dhunës seksuale, identiteti i personave nuk do të zbulohet pa pëlqimin e viktimës kur bëhet fjalë për fëmijët – pa lejen e prindërve ose kujdestarëve dhe vetë fëmijës (duke marrë parasysh moshën e fëmijës), nëse ka interes public dhe është në interesin më të mire të fëmijës. Media online do të mundsojë tërheqjen e pëlqimit në çdo kohë, nëse kërkohet nga prindi ose kujdestari.*

Neni 8

8.2. *Mediat online do të jenë veçanërisht të kujdesshme kur publikojnë pamjet e dhunës, brutalitetit apo vuajtjes, dhe prioritet i tyre do të jetë mbrojtja e dinjitetit të viktimave dhe atyre që janë prekur në çfarëdo mënyre nga ngjarjet.*

8.5. *Kur publikojnë intervista ose deklarata të autorëve të dhunës dhe krimet mediat online duhet të jenë të kujdesshme që të mos e vendosë veten në një pozicion për të promovuar idetë e tyre, duke inkurajuar kështu njerëzit të kryejnë krime ose të përhapin gjuhë të urrejtjes. Mediat online do të kenë parasysh se intervistimi i autorëve mund të jetë i dhimbshëm për viktimat dhe familjet e tyre.*

Neni 9

Gazetari nuk mund të intervistojë apo fotografojë fëmijë nën moshën 16 vjeç pa pëlqimin e prindërve apo kujdestarëve, përveç rasteve kur kjo është në përputhje me të drejtat e fëmijës. E njëjta vlen edhe për personat me nevoja të posaçme, të cilët nuk janë në gjendje të gjykojnë me vetëdije.

Neni 10

10.1. *Duke pasu parasysh rrezikun ndaj individëve, grupeve ose shoqërinë në tërësi, media online nuk do të nxisë kurrë urrejtje ose intolerance bazuar në racën, ngjyrën e lëkurës, origjinën, kombësinë ose përkatësinë etnike, gjininë, orientimin seksual, identitetin gjinor, grupin e marginalizuar, gjuhën, shtetësinë, origjina sociale, arsimimi, feja ose besimi, besimi politik, besimi tjetër, paaftësia, mosha, statusi martesor, gjendja pasurore, gjendja shëndetësore, statusi personal dhe statusi shoqëror ose ndonjë bazë tjetër.*

10.3. *Mediat online do të përpiqen të rrisin ndërgjegjësimin për pasojat negative të gjuhës së urrejtjes, të identifikojnë dhe zbulonë një fjalim të tillë, si dhe të vënë në dukje aktorët që e*

prodhojnë dhe e përdorin atë. Mediat online do të krijojnë përmbajtje që kundërshtonë gjuhën e urrejtjes dhe diskriminimin mbi baza të ndryshme.

3.2.3. III. Vetërregullimi që i përmbahet etikës gazetareske globale

Më tej, sipas Deklaratës FNG-së të principeve për sjellen e gazetarëve, të cilës gazetarët në Maqedoninë e Veriut pritët t'i përmbahen:

7. Gazetari duhet të jetë i vetëdijshëm për rreziqet e diskriminimit që mund të mbështetet nga media dhe duhet të bëjë çmos për të shmangur justifikimin e një diskriminimi të tillë, duke përfshirë në bazë të races, seksit, orientimit seksual, gjuhës, fees, opinioneve politike ose të tjera dhe kombëtare ose origjinë sociale.

Parimet e pranuarra përgjithësisht të vetërregullimit

Përgjegjësia për raportim me rrespekt, në veçanti për çështje të caktuara si dhuna, gjuha e urrejtjes, grupet e cenushme.

Ndjeshmëria ndaj çështjeve dhe qëllimeve të diskriminimit, të tilla si gjinia dhe treguesit ndërsektorial në raportim.

Përgjegjësi në luftën kundër shkeljeve dhe në mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Përgjegjësi për të mos nxitur urrejtje në bazë të, ndër të tjera, gjinisë.

Përgjegjësi për të mos promovuar diskriminimin.

Përgjegjësi „ për të mos shkaktuar dëm“ gjatë raportimit.

Tabela 1: Parimet e përgjithshme të pranuarra të vetërregullimit

Redaksitë, dhe me këtë mediat, kanë përgjegjësinë kryesore për të siguruar përputhjen me këto kode bazuar në:

- a. Përgjegjësia e përgjithshme për raportim të saktë; dhe
- b. mbrojtjen proaktive të vlerave njerëzore dhe barazisë nëpërmjet raportimit dhe përmbajtjen e njoftimit.

3.3. Dispozitat rregullatore

3.3.1. Ligji i Bashkimit Evropian

Direktiva (BE) 2018/1808 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e dates 14 nëntor 2018 për të ndryshuar Direktivën 2010/13/BE për të koordinuar disa dispozita të përcaktuara me ligj, rregullore ose akt administrative në Shtete Anëtare në lidhje me ofrimin e shërbimeve mediatike audiovizuale (Direktiva për shërbime mediatike audiovizuale), për shkak të ndryshimit së gjendjes të tregut⁴.

Rrjedhja e lire e shërbimeve në Evropë është gjithashtu subjekt i respektimit të komunikimeve që nuk nxisin dhunë, urrejtje dhe paragjykime:

Neni 3

1. Shtetet anëtare sigurojnë lirinë e pritjes dhe nuk do të kufizojnë në territoret e tyre ritransmetimin e shërbimeve mediatike audiovizuale nga shtetet e tjera anëtare për arsye të përfshirjes nga fushat e mbuluara nga kjo Direktivë..
2. Një shtet-anëtare mund të tërhiqet përkohësisht nga paragrafi 1 i këtij neni nëse një shërbim i veçantë mediatik audiovizual i ofruar nga një transmetues i shërbimit mediatik nën juridiksionin e

⁴ <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32018L1808&from=EN>

një shteti tjetër anëtar shkel qartë, seriozisht dhe rëndë pikën (a) të nenit 6(1), ose nenin 6a(1), ose e vë në pikëpyetje shëndetin publik ose paraqet rrezik serioz për shëndetin.

[...]

3. *Një shtet-anëtare mund të tërhiqet përkohësisht nga paragrafi 1 i këtij neni nëse një shërbim i veçantë mediatik audiovizual i ofruar nga një transmetues i shërbimit mediatik nën juridiksionin e një shteti tjetër anëtar shkel qartë, seriozisht dhe rëndë pikën (b) të nenit 6 6(1), ose vë në pikëpyetje sigurinë publike ose ose paraqet rrezik serioz dhe të rëndë të vë në pikëpyetje sigurinë publike duke përfshirë mbrojtjen e sigurisë dhe mbrojtjes kombëtare.*

[...]

Neni 6

1. [...] *Vendet anëtare do të kujdesen që komunikimet komerciale audiovizuale të ofruara nga transmetuesit e shërbimeve mediatike që janë nën kompetencat e tyre të jenë në përputje me kërkesat e mëposhtme:*

(a) nxitje për dhunë ose urrejtje të drejtuar kundër një grupi personash ose një anëtar të një grupi për cilindo nga arsyet e përmendura në nenin 21 të Kartës;

[...]

Neni 9

1. *Vendet anëtare do të kujdesen që komunikimet komerciale të ofruara nga transmetuesit e shërbimeve mediatike që janë nën kompetencat tyre të jenë në përputhje me kërkesat e mëposhtme:*

[...]

(b) komunikimet komerciale audiovizuale nuk guxojnë:

(I) të vënë në pikëpyetje respektin për dinjitetin njerëzor;

(II) të përfshijnë ose promovojnë çdo formë diskriminimi bazuar në seksin, origjinën racore, ose etnike, kombësinë, fenë, ose besimin, paaftësinë, moshën ose orientimin seksual; etnike, kombësinë,

(III) të nxisin sjelljen që është e dëmshme për shëndetin ose sigurinë.

[...]

Në përputhje me Direktivën, vendet anëtare të BE-së duhet të kujdesen që komunikimet komerciale audiovizuale të ndara nga transmetuesit e shërbimeve mediatike të mos përfshijnë ose promovojnë çfardo diskriminimi në disa baza. Vendet anëtare të BE-së patjetër të kujdesen që shërbimet mediatike audiovizuale të mos përmbajnë çfardo lloji nxitjeje për dhunë ose urrejtje kundër një grupi personash ose anëtarë të një grupi mbi ndonjë nga arsyet e përcaktuara në nenin 21 të Kartës së të Drejtave Themelore të BE-së. Në rastin e raportimit dhe programeve të ngjajshme të bazuara në fakte, vendosja komerciale mund të llogaritet si komunikim komercial.

Më në fund, paragrafi 4 vë në dukje se për shkak të ndikimit të konsiderueshëm të mediave sociale në ndërtimin dhe ndikimin mbi opinionin publik, këto shërbime duhet të përfshihen në fushëveprimin e Direktivës deri në atë shkallë që ato të plotësojnë definicionin e shërbimit të platformës së ndarjes së së videove. Në atë mënyrë, për ta do të vlejë rregulla të ngjajshme për mbrojtjen nga diskriminimi dhe gjuha e urrejtjes.

3.3.2. Karta e të Drejtave Themelore të BE-së

Neni 21

1. Ndalohet çfardo lloji i diskriminimit në bazë të seksit, races, ngjyrës, origjinës etnike ose shoqërore, karakteristikave gjenetike, gjuhës, fees ose besimit, mendimit politik ose mendimi tjetër, përkatësisë së pakicës kombëtare, pronës, lindjes, nevojave të veçanta ose orientimit seksual.
2. Në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes për themelimin e Komunitetit Evropian dhe Marrëveshjes për Bashkimin Evropian, dhe në kontekstin e dispozitave të veçanta të këtyre Marrëveshjeve, ndalohen të gjitha format e diskriminimit në bazë të kombësisë.

3.3.3. Konventa për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore – KEDNJ 1950

Neni 10 i Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut të vitit 1950 thotë: „Çdo njeri ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshinë lirinë e mendimit, dhe lirinë për të marrë dhe përhapur informacione dhe ide përmes çdo mjeti pa ndërhyrje të autoritetit publik dhe pavarësisht nga kufijtë.“ (Neni 10(1)). Megjithatë, e drejta për lirinë e shprehjes nuk është një e drejtë absolute. Realizimi i tij bart „obligime dhe përgjegjësi“ dhe mund të jetë subject i kufizimeve të përcaktuara me ligj, në lidhje, për shembull, me mbrojtjen e reputacionit dhe të drejtave të të tjerëve (Neni 10(2)).

Neni 10 lexohet në lidhje me Nenin 17 që ndalon abuzimin e të drejtave, si më poshtë:

“Asnjë dispozitë e Konventës nuk mund të interpretohet në mënyrë që t’i jape një shteti, grupi ose individit të drejtën për t’u përfshirë në ndonjë aktivitet ose përr ndonjë veprim tjetër ose për ndonjë të veprim tjetër ose për ndonjë formë shkeljeje të kësaj Konvente, ose të kufizojë këto të drejta dhe liri në masë më të madhe se ato të parashikuara në Konventë”.

Neni 14 од KEDNJ përmban dispozitë për mosdiskriminimin:

“Të gëzuarit e të drejtave dhe lirive të njohura nga kjo Konventë do të garantohet pa asnjë diskriminim në bazë të seksit, races, ngjyrës, gjuhës, fees, opinionëve politike ose të tjera, origjinës kombëtare ose sociale, kombësisë së një pakice kombëtare, pozitës material, origjinës së lindjes ose çfardo statusi tjetër”.

Protokoli nr..12 I Konventës për Mbrojtjen e të drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore përfshin ndales të përgjithshme të diskriminimit. Dispozita vijuese e mosdiskriminimit të KEDNJ-së (Neni 14) ka një shtrirje të kufizuar pasi ndalon vetëm diskriminimin en gëzimin e të drejtave të garantuara nga Konventa. Protokoli nr..12 heq këtë kufizim duke garantuar se askush nuk do të diskriminohet për asnjë arsye dhe nga asnjë autoritet publik.

E drejta „ të menduarit dhe për të marrë dhe për të dhënë informacione ose ide pa ndërhyrje nga autoriteti publik dhe pavarësisht nga kufijtë“ nuk është një e drejtë absolute dhe kufizimet mund të zbatohen për të mbrojtur të drejtat e të tjerëve, siç është e drejta për lirinë nga diskriminimi (KEDNJ Neni 14). Definicioni I gjuhës së urrejtjes i përdorur nga Këshilli I Evropës dhe Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) përfshinë terma që nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen e bazuar në intolerancë. Në çështjet aktuale, Gjykata përdor nenin 10 në kombinim me neni 17, me përjashtim të rasteve të jashëzakonshme kur mund të thirret mbrojtja e fjalës së lire, sepse menjëherë është e qartë se liria e shprehjes nuk pasqyron qëllimin e vërtetë, por thirret në atë mbrojtje me qëllim pjesëmarrjen

në aktivitete ose kryerjen e veprave që synojnë shkatërrimin e të drejtave dhe lirive sipas Konventës, e gjitha me qëllim për të nxitur urrejtje ose dhunë.⁵

3.3.4. Konventa për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit)

Konventa e Stambollit përfshin definicionin e pare ligjërisht të detyrueshëm të gjinisë: “Gjinia nënkupton rolet, sjelljet, aktivitetet dhe atributet e ndërtuara shoqërore që një shoqëri e caktuar i konsideron të përshtatshme si për grate ashtu edhe për burrat”.

Konventa dënon të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe përmban katër nene që janë në veçanti të rëndësishme për çështjen e gjuhës së urrejtjes seksiste.

Konventa e Stambollit trajton kontekstin më të gjërë kulturor dhe rolin specifik të medias sim ë poshtë:

Neni 12 – Obligimet e përgjithshme

1. *Palët i marrin masat e nevojshme për të promovuar ndryshime në modelet sociale dhe kulturore të sjelljes së grave dhe burrave, me qëllim të çrrnjosjes së pargjytimeve, zakonet, traditat dhe të gjitha praktikatat tjera të bazuara në idenë e inferioritetit të grave ose në rolet stereotipe për grate dhe burrat.*
2. *Palët i marrin masat e nevojshme legislative dhe masat e tjera për të parandaluar të gjitha format e dhunës të përfshira nga kjo Konventë të çdo personi fizik ose juridik.*
3. *Të gjitha masat e ndërmarra në përputhje me këtë kapitull I marrin parasysh dhe trajtojnë nevojat specifike të personave që janë bërë të cenueshëm në rrethana të caktuar dhe do të vendosin në qendër të tyre të drejtat e njeriut të të gjitha viktimave.*
4. *Palët i marrin masat e nevojshme për të inkurajuar të gjithë anëtarët e shoqërisë, veçanërisht burrat dhe djemtë, që të marrin pjesë aktive në parandalimin e të gjitha formave të dhunës të përfshira nga kjo Konventë.*
5. *Palët do të sigurojnë që kultura, zakonet, feja, tradita, ose i ashtuquajturit „nder“ nuk do të pranohen si justifikim për çfardo akti të dhunës të përfshirë nga kjo Konventë.*
6. *Palët do të marrin masat e nevojshme për të promovuar programet dhe aktivitetet për fuqizimin e grave.*

Neni 17 – Pjesëmarrja e sektorit privat dhe mediat

1. *Palët do të inkurajojnë sektorin privat, sektorin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit me mediat, duke rrespektuar lirinë e shprehjes dhe pavarsinë, të marrin pjesë në formulimin dhe zbatimin e politikave dhe të vendosin udhëzime dhe standarde vetërregulluese për parandalimin e dhunës ndaj grave dhe rritjen e rrespektit për dinjitetin e tyre.*
2. *Palët do të zhvillojnë dhe promovojnë, në bashkëpunim me aktorët e sektorit privat, aftësitë ndërmjet fëmijëve, prindërve dhe edukatorëve se si të përballen me mjedisin e ri të informacionit dhe komunikimit, i cili jep akses në përmbajtje degraduese të natyrës seksuale ose të dhunshme, e cila mund të jetë e dëmshme.*

Neni 18

3. *Palët do të kujdesen që masat e marra në përputhje me këtë kapitull:*

– janë të bazuara mbi kuptimin gjinor të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje dhe fokusohen në të drejtat e njeriut dhe sigurinë e viktimës;

⁵ Aktgjykim i KEDNJnë rastin PERINÇEK kundër Zvicrrës (GC), nr. 27510/08, 15/10/2015, paragraf 114-115)

- janë të bazuara mbi qasje të integruar që merr parasysh marrëdhëniet ndërmjet viktimave, autorëve, fëmijëve dhe mjedisit të tyre më të gjërë shoqëror;
- janë të orientuar për shmangien e viktimizimit sekondar;
- janë të orientuar drejt forcimit dhe pavarësisë ekonomike të grave viktimave të dhunës;
- lejojnë, kur është e përshtatshme një sërë shërbimesh për mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave të vendosën në të njëjtat ambiente;
- trajtohen nevojat specifike të personave vulnerabël, duke përfshirë fëmijët-viktima, dhe t’ju jenë ato në dispozicion.

Neni 42 – Justifikimi I papranueshëm për krimet, duke përfshirë krimet e kryera në emër të të ashtuquajturit „nderi“

1. *Palët do të marrin masat e nevojshme legjislative dhe masat e tjera për të siguruar që në procedimet penale të nisura për shkak të kreyrjes së çdo akti dhune të përfshirë nga Konventa, kultura, zakonet, feja, tradita ose I ashtuquajturit „nder“ nuk guxon të pranohet si justifikim për akte të tilla. Këto në veçanti përfshihen pretendimet se viktimave ka shkelur normat ose zakonet kulturore, fetare, sociale ose tradicionale të slljes së duhur.*

2. *Palët do të marrin masat e nevojshme legjislative dhe masat e tjera për të siguruar që nxitja e fëmijës për të kryer ndonjë nga veprimet e parapara në paragrafin 1 nuk do të zvogëlojë përgjegjësinë penale të nxitësit të veprës penale.*

Neni 34 – Përndjekja “Palët do të marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të siguruar që sjellja e qëllimshme e kërcnimeve të përsëritura të drejtuara ndaj një personi tjetër, duke I shkaktuar atij frikën për sigurinë e tij ose të saj, të inkriminohet.”

Neni 40 – Ngacmim seksual “Palët do të marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të siguruar që çdo formë e sjelljes së padëshiruar verbale, joverbale ose fizike të natyrës seksuale me qëllim ose efekt të cenimit të dinjitetit të personit, sidomos kur krijohet një mjedis frikësues, armiqësor, degradues, poshtëruës ose fytes ai i nënshtrohet sanksioneve penale ose të tjera ligjore.”

Rekomandimi CM/Rec(2013)1 I Komitetit të Ministarve për barazinë gjinore dhe mediat. I destinuar për shtetet anëtare dhe organizatat mediatike, Rekomandimi përfshin udhëzime dhe propozimaktivitetesh për luftimin e stereotipeve gjinore në media. Një manual për zbatimin e Rekomandimit është publikuar në vitin 2015.

3.3.5.Ligji për shërbimt mediatike audio dhe audiovizuele¹¹

Ligji për shërbimet mediatike audio dhe audiovizuele rregullon radion dhe televizionin, si shërbimet mediatike audiovizuele sipas kërkesës dhe thekson si në vijim:

Neni 61

Parimet

Transmetuesit gjatë kryerjes së veprimtarisë së tyre duhet të rrespektojnë parimet në vijim:

- *përkujdesje dhe zhvillimin e vlerave humane dhe morale të njeriut dhe mbrojtjen e privatësisë dhe dinjitetit të personit,*
- *barazia e lirive dhe të drejtave pavarësisht nga gjinia, raca, origjina kombëtare, etnike dhe sociale, bindjet politike dhe fetare, statusi pasuror dhe shoqëror dhe qytetarit,*
- *nxitja e frymës së tolerances, rrespektit dhe mirëkuptimit të ndërsjellë ndërmjet individëve me prejardhje të ndryshme etnike dhe kulturore,-mbrojtja e identitetit të viktimave të dhunës,*
- *rrespektimi i prezumimit të pafajsisë,*
- *nxitja e mirëkuptimit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, ndjenjës së drejtësisë për publikun dhe mbrojtjes së lirive demokratike,*
- *hapja e programeve për shprehjen e kulturave të ndryshme që janë pjesë përbërëse e shoqërisë,*
- *ruajtje dhe përkujdesje e identitetit kombëtar, kulturës gjuhësore dhe krijimtarisë vendase,*
- *prezantim objektiv dhe të paanshëm i ngjarjeve me trajtim të barabartë të pikëpamjeve dhe opinionëve të ndryshme dhe duke mundësuar formimin e lire të opinionit të audiencës për ngjarje dhe çështje të caktuara,*
- *rrespektimi i të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta,*
- *rrespektimi i fshehtësisë së burimit të informacionit,*
- *garantimin e të drejtës së përgjigjes dhe korrigjimit dhe*
- *vetëqeverisës, pavarësia dhe përgjegjësia e redaktorëve, gazetarëve dhe autorëve të tjerë në krijimin e programeve dhe krijimin e politikave redaktuese.*

¹¹ Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 184/2013, 13/2014, 44/2014, 101/2014, 132/2014, 142/2016, 132/2017, 168/2018, 248/2018 и 27/2019 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 42/2020 и 77/2021)

neni 48

Ndalesa të veçanta

- (1) *Shërbimet mediatike audio dhe audiovizuale nuk guxojnë të përmbajnë programe që rrezikojnë sigurinë kombëtare, nxisin përmbysjen e dhunshme të rendit kushtetues të Republikës së Maqedonisë, thirrje për agression ushtarak ose konflikt të armatosur, nxisin ose përhapin diskriminimin, intolerancë ose urrejtje në bazë racore, ngjyra e lëkurës, origjina, kombësia ose përkatësia etnike, gjinia, seksi, orientimi seksual, identiteti gjinor, grupi i marginalizuar, gjuha, shtetësia, origjina sociale, arsimit, feja ose besimi fetar, bindja politike, paaftësia, mosha, statusi martesor ose statusi pasuror, gjendja shëndetësore, statusi personal dhe statusi shoqëror, ose çfardo baze tjetër.*
- (2) *Ndalesat e veçanta nga paragrafi (1) I këtij neni duhet të jenë në përputhje me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.*

3.3.6. Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje⁶

Në janar të vitit 2021, u miratua ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje, si masë e paraparë me Planin Kombëtar të veprimit për zbatimin e Konventës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Ligji trajton çështjen e rolit të medias në parandalimin dhe luftimin e DHBGJ-së në nenet 33, 34 и 37.

I përmend mediumet si faktorë që duhet „të marrin masa promovuese për të rritur ndërgjegjësimin për të gjitha format e dhunës me bazë gjinore, për të promovuar barazinë gjinore dhe për të eliminuar stereotipet me bazë gjinore të bazuara në kulturë, zakone, besime, tradita dhe praktika të tjera që bazohen në idejën e vartësisë të grave dhe burrave“ (neni 33).

Për ta bërë këtë, ligji parashikon që media duhet të:

Neni 34

[...]

- “2) zhvillojnë fushata për të njohur pasojat e dhunës me bazë gjinore ndaj grave dhe dhunës në familje;
- 3) krijojnë system për publikimin e rregullt të informative për masat e sigurisë, këshilla dhe informata tjera të dobishme për parandalimin e dhunës; dhe
- 4) bashkëpunojnë me njëri-tjetri në promovimin dhe parandalimin e dhunës me bazë gjinore ndaj grave dhe dhunës në familje.”

Ligji përcakton që mediat duhet të marrin këto masa në përputhje me aftësitë dhe politikën editorial të pavarur dhe vetëqevrisës, si dhe të marrin masat e mëposhtme preventive:

Neni 37

[...]

- “1) gjatë krijimit dhe transmetimit të programeve informative dhe edukative, ata duhet të kujdesin për ndërgjegjësimin e publikut të gjërë për të gjitha format e dhunës me bazë gjinore ndaj grave dhe dhunës në familje, promovimin e barazisë gjinore dhe eliminimin e stereotipeve për rolet gjinore; dhe
- 2) në mënyrë të pavarur ose përmes shoqatave profesionale të gazetarëve dhe punonjësve të medias, të vendosin krijojnë bashkëpunim me shoqatat për të forcuar kapacitetet e tyre për raportim profesional për çështje që kanë të bëjnë me dhunë ndaj grave në familje.”

| Qëllimet rregullatore të përgjithshme të pranuara: Mediat që raporojnë për dhunën me bazë gjinore ndaj grave |
|---|
| Promovoni rrespektimin e të drejtave të njeriut në pikëpamje të grave dhe dhunës me bazë gjinore ndaj grave. |
| Luftoni kundër dhunës ndaj grave duke luftuar stereotipet rreth grave; meshkujt, rolet gjinore dhe vlerat gjinore në shoqëri. rolet gjinore dhe vlerat gjinore në shoqëri. |
| Mos merrni pjesë në viktimizim dhe në viktimizimin sekundar dhe përmbahuni nga riprodhimi i stereotipeve seksiste dhe atyre që kanë të bëjnë me karakteristikat ndërsektoriale si gjinia dhe përkatësia etnike. |
| Aplikoni raportim kritik në lidhje me rastet e dhunës dhe dhunës si fenomen social, duke përfshirë edhe përgjegjësinë institucionale. |
| Ofroni përmbajtje që i përmbahet etikës profesionale dhe kodeve të sjelljes, si dhe parimeve të së drejtës për lirinë e fjalës në luftën kundër dhunës. |
| Liria e shprehjes nuk është e barabartë me shkeljen e të drejtave të tjera të njeriut si mosdiskriminimi, dinjiteti, liria nga dhuna. |
| Mbroni individët vulnerabël, viktimat dhe të mbijetuarit e dhunës, siç janë të miturit kur raportoni. |

Tabela 2: Qëllimet rregullatore të përgjithshme të pranuara në raportimin e medias

4. Tiparet e monitorimit

4.1. Hyrje

Kuptimi themelor i karakteristikave globale të raportimit mediatic të dhunës ndaj grave

Duke marrë parasysh literature shkencore ndërkombëtare për periudhë disa dekadash si dhe rastet më të fundit të studimeve kombëtare nge e gjithë bota, duke përfshirë Australinë dhe vendet e Amerikës Latine etj., ekzistojnë çështje specifike sistematike dhe sistemore problematike në pasqyrimin mediatic të dhunës ndaj grave. Ato janë të paraqitë më poshtë. Mund të thuhet me siguri se edhe pse jo të gjitha mediat tregojnë praktika të këqija dhe se kjo bëhet gjetë gjithë kohës, një ose më shumë nga ato karakteristika mund të gjenden në raportim në një moment të caktuar. Raportimi është më neutral kur bëhet fjalë për vende të largëta gjeopolitikisht dhe kulturalisht. Megjithatë, kur një nga këto karakteristika është evidente në raportim, atëherë është me rëndësi të kryhet kontroll më i detajuar.

Përgjithësisht janë krijuar praktika të vazhdueshme mediatike në raportimin e dhunës ndaj grave në studime ndërkombëtare dhe afatgjate

Mungesa e raportimit rreth kontekstit social ku dhunuesit meshkuj janë të dhunshëm ndaj grave dhe fëmijëve.

Vazhdimi i miteve, keqinterpretimeve dhe stereotipeve.

Atribuimi i fajit dhe përgjegjësisë për viktimat e mbijetuara.

Numër i kufizuar votash të „ekspertëve“, dominohen nga organet për zbatimin e ligjit.

Paraqitja e kufizuar e ndjeshmërisë dhe njohurive për ndikimin, dëmin dhe pasojat e dhunës mbi viktimat dhe komunitetet.

Tabela 3: Praktikrat e këqija të përgjithësuar të vazhdueshme në media kur raportohet për dhunën ndaj grave

4.2.Rekomandim se si t,i qasemi procesit të monitorimit

Konsistenca, koherenca, besueshmëria dhe metodologjia janë elemente të rëndësishme në procesin e monitorimit. Këshillohet që personat e ngarkuar me monitorimin dhe të përfshirë në procesin e analizës të lexojnë dhe shohin një here raportin e plotë gazetaresk dhe të mbajnë shënime për tonin , mesazhin dhe gjatësinë e raportit, si dhe renditjen e tij në kontekstin e lajmeve të tjera. „Leximi“ i pare mundëson vendosjen e tonit të përgjithshëm dhe qasjes ndaj temës. Për më tepër, stories në një sekuençë të monitorimit të lajmeve/artikujve mund të përcaktojë seriozitetin dhe rrespektin që I jepet (p.sh. mjedisi është i ndryshëm kur një histori prezantohet në kohën kryesore dhe midis temave serioze sociale; toni është i ndryshëm kur tregohet pasohet nga një tjetër që përshkruan lindjen e derrave të vegjël në një park kombëtar dhe kur ata kanë të njëjtën gjatësi). Duke ndjekur të njëjtën logjikë, përcaktimi i vendit të raportimit Brenda përmbajtjes më të gjërë të programit, madje edhe programit, do të kishte të njëjtin qëllim.

4.2.1. Shqyrtimi paraprak i stories

Shënime që duhen mbajtur:

- ⇒ Gjatësia e raportit,
- ⇒ Storia e mëparshme: tema dhe gjatësia,
- ⇒ Storia tjetër: тема и должина,
- ⇒ Tregimi dhe tema,
- ⇒ Kush duket se ka zërin, kush citohet?
- ⇒ Kush hesht?
- ⇒ Kush duket se është I mbrojtur: autori I dhunës? Viktima/i mbijetuari?
- ⇒ Cilat imazhe shoqërojnë storien?

4.2.2. Pyetje të përgjithshme të synuara

Pyetjet në vijim identifikojnë të dhënat e monitorimit që ndihmojnë në gjetjen e kontekstit më të gjërë gjatë krijimit të raportit.

I. Cilat fusha të dhunës me bazë gjinore ndaj grave janë përshkruar në raport ?

1. Abuzimi i grave me bazë gjinore dhe aktivitete konkrete gjinore, si ushqyerja me gjë,
2. Frikësim kibernetik, ngacmim online, gjuha e urrejtjes,
3. Martesa e fëmijëve/martesa e hershme/martesa e detyruar,
4. Sjellja kontrolluese, duke përfshirë edhe dhunën ekonomike,
5. Gjymtimi/prerja e organeve gjenitale femërore,
6. Femicidi/vrasja e foshnjave,
7. Dhuna psikologjike, emocionale,
8. Kërcnimi/abuzimi i fëmijëve,
9. Ngacmime seksuale, sulme seksuale, përdhunime,
10. Vepër penale të kryer në emër të të ashtuquajturve „nderi”,
11. Tregtimi me qenie njerëzore, kontrabanda,
12. Dhuna ndaj grave në konflikt, konflikt të armatosur,
13. Dhuna ndaj grave në zgjedhje, pjesëmarrje politike, pjesëmarrje publike,
14. Dhuna nga partneri intim/ish-partneri, dhunë në familje/vrasje,
15. Dhuna riprodhues ndaj grave (nga ana e shtetit, autoritetet, institucionet shëndetësore, etj.),
16. Të tjera.

II. Cili është konteksti aktual socio-politik i dhunës?

1. Dhuna publike ndaj grave, për shembull gazetarë, politikanë, figura publike, aktiviste, autore,
2. Dhuna në politikë, p.sh. zgjedhje, referendum, demonstrata,
3. Dhuna në kuadër të ngjarjeve sportive,
4. Dhuna në kuadër të ngjarjeve kulturore,
5. Dhuna në kontekstin e një krize,
6. Tjera.

III. Cilat janë arsyet e ankesës/në rastin?

IV. A mund të identifikohen shkelje të ngjajshme gjatë një perudhe kohore ose në media të shumta me përmbajtje të njëjtë ose të ngjajshme?

V. A ekziston një shabllon i mundshëm për trajtimin e një rasti të dhunës? Mediat janë në pronësi të së njëjtës kompani apo nën të njëjtin kontroll editorial? A është autori/autorët/janë të njëjtë? A mund të identifikohen autorët? A është kjo storie e tipit „kopjo/ngjit“?

4.2.3. Pyetje gjenerike në kontekstin e stories/artikullit

Pyetjet në vijim kanë për qëllim të vlerësojnë informacionin kontekstual në me raportin dhe tonin kontekstual që ai përcjell.

1. A lë ndonjë dyshim raporti që përshkruan dhunën se është një incident i dhunshëm?
2. A është raporti konfuz për çështjen e dhunës ndaj grave?
3. A çon toni i përdoruar për të përshkruar ngjarjen në ndonjë mënyrë në paragjykim, veçanërisht ndaj viktimës/të mbijetuarit?

4. A e paraqet raporti ngjarjen pa informacion kontekstual për dhunën ndaj grave?
5. A është raporti i prirur për të minimizuar shkallën dhe ashpërsinë e dhunës ndaj grave në çfarëdo mënyre, për shembull përmes fotografive, kajros/gjuhës së trupit, tonit të prezantimi dhe audios, komenteve të tjera?
6. A përforcon, legjitimon, normalizon apo justifikon në ndonjë mënyrë raporti qëndrimet seksiste ndaj grave dhe justifikon dhunën?
7. A cenon raporti ndonjë nga standardet profesionale?

Nëse përgjigja për një ose më shumë nga këto pyetje është „po“, atëherë duhet të bëhen pyetje më të detajuara në lidhje me shtrirjen dhe natyrë e shkeljes së etikës së medias.

4.2.4. Pyetje konkrete në lidhje me përmbajtjen e stories/artikullit

I. Lidhur me viktimën/të mbijetuarin

1. A janë personi/personat të portretizuar në ndonjë mënyrë si të dobët dhe si rrjedhim përgjegjës për mosmbrojtjen e tyre?
2. A janë personi/personat të portretizuar si shumë budalla apo tepër të pa përgjegjshëm për të mos u mbrojtur?
3. A janë paraqitur personi/personat si provokues, sugjestionues, se po e „kërkojnë“ veçanërisht në mënyrë seksuale?
4. A janë paraqitur personi/personat se po bëhen viktimë/të mbijetuarit në lidhje me paraqitjen e tyre?
5. A janë paraqitur personi/personat e portretizuar në ndonjë mënyrë si „të merituar“ për dhunë për shkak të sjelljes së tyre morale, seksuale ose kulturore, të së kaluarës, përkatësisë etnike ose marrëdhënieve të tyre?
6. A është personi i paraqitur në mënyrë akuzuese apo poshtëruese?
7. A është paraqitur personi në ndonjë mënyrë përgjegjës për sulmin?

II. Paraqitja e dhunuesit/sulmuesit

1. A paraqiten personi/personat si të paqëndrueshëm?
2. A paraqiten personi/personat si „përbindësh“?
3. A paraqiten personi/personat se janë detyruar të sulmojnë/abuzojnë?
4. A paraqiten personi/personat se kanë kryer një krim pasioni?
5. A paraqiten personi/personat se nuk kanë pasur zgjidhje tjetër (përveç kryerjes së krimit të dhunshëm)?
6. A paraqite personi/personat si të dhunshëm për shkak të racës/klasës/shkollimit, pra jashtë normave të pranuar?

III. Paraqitja e ngjarjes

1. A është paraqit si incident i izoluar?
2. A është paraqit si incident i jashtëzakonshëm që bie në sy në një shoqëri ku përgjithësisht nuk ka dhunë?
3. A është paraqit si krim pasioni/nderi, shprehje „dashurie“ dhe përgjithësisht e një „morali“ më të lartë kulturor?
4. A është paraqit si „sakrificë“ për „të mirën e përgjithshme“?
5. A paraqitet si „mësim“ dhe paralajmërim për gratë e tjera?
6. A është paraqitë si çështje private?

7. A atribohet ngjarja kryesisht kushteve „jashtëzakonshme“ siç është teknologjia që promovon fjalimin e dhunshëm?

4.2.5. Mjetet specifike komunikim në raportim

I. Gjuha

1. A përdoret një gjuhë jo precise ose e pasaktë për të përshkruar ngjarjen?
2. A përdoren fjalë me rëndësi kulturore, veçanërisht me kuptime fyese?
3. Kajroni, gjuha e trupit apo apo mjete tjera tekstuale e keqinterpretojnë apo e paraqesin storien të shtrembëruar?
4. A është gjuha një mjet, në çdo kohë për të adresuar pyetjet që lidhen me dhunuesin, viktimën/të mbijetuarit dhe ngjarjen? Kur pyetjet janë sugjестive apo akuzuese ndaj viktimës dhe në frymën e kriterëve të dhëna këtu, a i mbështet gjuha ato me mbiemra apo shprehje, drejtpërdrejt apo tërthorazi?
5. A fton gjuha për dënimi apo justifikimin e dhunës ndaj grave?
6. A e bën gjuha dhunën joshëse apo sensacionale?
7. A përdoret gjuha për „mësimdhënie“?
8. A krijon gjuha viktimizimin dytësor?
9. A është toni i artikulli i ashpër, i vrazhdë ose imponues, veçanërisht në lidhje me të mbijetuarit?
10. A është toni i artikullit i ashpër apo manipulues, veçanërisht në lidhje me të miturit?
11. A është gjuha stereotipike?
12. A është gjuha passive dhe sugjeron faj?

II. Intervistat me viktimat/të mbijetuarit

1. A ka shkelje të protokollit dhe etikës së pritshme gjatë intervistimit të fëmijëve ose individëve të tjerë vulnerabël?
2. A janë publik emri ose personi ose karakteristika të tjera të viktimës/të mbijetuarit, apo informacioni në raport mund të çojë në identifikimin e tyre pa pëlqimin e tyre ose lejen e gjykatës?
3. A përdoret përkthyes kur nevojitet?
4. A është intervistuar autori dhe a janë pranuar pikëpamjet e tij dhe a janë përdorur direct apo indirect si justifikim për dhunën? Kjo poashtu arrihet edhe nëse lejohen pjesë problematike të intervistës dhe mungon komenti nga gazetari.

III. Materiale vizuale

1. A përdoren regjistrime vizuale të paautorizuara të viktimës/të mbijetuarit?
2. A përdoret materiali vizuel i viktimës për të përfaqësuar viktimën/të mbijetuarin në mënyrë të pafavorshme dhe si rrjedhim sugjeron fashësinë? A kontribuojnë imazhet në trajtimin akuzues apo degradues të viktimës/të mbijetuarit?
3. A është e saktë përzgjedhja e imazheve dhe redaktimi i tyre dhe a e paraqesin ngjarjen në mënyrë korrekte dhe të rrespektueshme?
4. A janë imazhet shumë të detajuara dhe shqetësuese dhe nuk përcjellin informacion? A përdoren për sensacionalizëm në ngjarje?
5. Imazhet i infantilizojnë apo i bëjnë të pafuqishme?

IV. Mbulim i përgjithshëm

1. A e rrezikon raportimi sigurinë e mëtejshme të viktimës/të mbijetuarit apo të vartësve të tyre?
2. A është i padukshëm autori mashkull i dhunës (qoftë përmes tekstit apo imazhit) në raportim? Kjo bëhet duke u fokusuar tek ngjarja e (dhunës) „çfarë po i ndodhë“ viktimës/të mbijetuarit.
3. A është raportimi i paqartë dhe ambivalent për sa i përket dinamikës, ndikimit dhe dëmtimit të dhunës ndaj grave?
4. A e minimizon raportimi dëmin e dhunës? Mjetet e shpeshta janë banalizimi i dhunës dhe akuzave ndaj grave, si de dehumanizmi i grave.
5. A jep raporti ndonjë argument apo sugjerim që justifikon dhunën ndaj një viktime/të mbijetuarit të caktuar dhe/ose dhunën ndaj grave në përgjithësi?

5. Praktika të mira gjatë raportimit

Vërejtjet në vijim shërbejnë si një kujtesë për Agjencinë dhe profesionistët e medias për mundësitë që disponon media për të përmirësuar raportimin për dhunën në bazë gjinore ndaj grave. Ato shërbejnë gjithashtu si kundërkritere për rritjen e cilësisë së dëshiruar të raportimit dhe debatit publik. Këto elemente të praktikës së mire mund të përdoren për të dhënë propozime konkrete për mediat dhe për t'u përdorur si referimi për krahasim.

Është thelbësore të përmendet se praktikatat e mira trajtojnë në mënyrë proaktive mitet që lidhen me DHBGJ-në. Mediat luajnë rol të veçantë në trajtimin, luftimin dhe parandalimin e dhunës ndaj grave kur zbatohen praktikatat e mira:

- Duke dhënë një pasqyrë të plotë se çfarë është dhuna;
- Duke kërkuar kontekstin për shkaqet që çojnë në DHBGJ dhe ndikimin e dhunës tek gratë në shoqëri;
- Përmes raportimit kritik mbi përgjegjësinë e autoriteteve dhe organeve përgjegjëse për mbrojtjen e grave;
- Duke debuzuar sistematikisht mitet e lidhura me DHBGJ;
- Duke u dhënë zë grave.

Etika e raportimit të DHBGJ-së është në përputhje me udhëzimet e përgjithëshme globale që përshijnë udhëzimet për gazetarët dhe redaktorët, siç janë:

- Dhuna ndaj grave është shkelje e të drejtave njerëzore të grave dhe si e tillë duhet raportuar;
- Dhuna ndaj grave nuk është e ndarë nga çështjet e sigurisë njerëzore;
- Ekspozim i kufizuar ndaj imazheve sensacionale ose përdorimi i një gjuhe të tillë;
- Mos dhënia e informacionit që çon në identifikimin e një personi që i ka mbijetuar një sulmi të dhunshëm bazuar në rrezikun e zbulimit;
- Zbatimi i kushteve të veçanta kur kërkohen përgjigje/intervista nga/me të mbijetuarit;
- Mospërdorimi i fjalës gjykuese;
- Sulmi nuk duhet të klasifikohet në rubrikë „kronika e zezë“;
- Përdorimi i gjuhës saktë/terminologjinë: përdhunim, ngacmim seksual, dhunë nga partneri intim;
- Raportimi mbi kontekstin social;
- Të mos përdoren vetëm juristët si ekspertë në diskutimin e sulmit, por edhe burime tjera si OJQ-të, shkencëtarët socialë, organizatat e grave, psikologët;

- Sigurimi I kontekstit dhe hetimit për shkaqet se pse është e vështirë për grate të ikin nga mjediset e dhunshme, duke përfshirë plogështinë dhe joefikasitetin e institucioneve, stigmën, mungesën e mbështetjes;
- Sigurimi i informacioneve për shërbimet lokale;
- Përdorimi i gjuhës aktive dhe përcaktimi i qartë i marrëdhnieve për të treguar se autorët shpesh vijnë nga rrethi i ngushtë të grave; dhe
- Në rastet e përkatësisë etnike ose të interseksionalizmit (mosha, orientimi seksual, përkatësia etnike, klasa) theksoni ndikimin e racizmit, privimit, traumës ndër breza dhe mos përdorni stereotype.

Parimet e përgjithshme të pranura të praktikës së mire në raportimin e mediave për DHBGJ-në

Njoftim

Përmbahet nga arsyetimi, justifikimi, sensacionalizmi, banalizmi ose joshja e çdo forme të DHBGJ-së përmes gjuhës, mjeteve vizuale ose të tjera të komunikimit.

Përmbahet nga paraqitja e dhunës ndaj grave si një incident të izoluar dhe/ose autorëve si „përbindësh“, situatë të paqëndrueshme ose ekstreme. Ofron kontekst dhe informacion të dobishëm për të mbijetuarit.

E trajton dhunën ndaj grave si një shkelje të të drejtave të njeriut, çështje të sigurisë njerëzore dhe një çështje me interes demokratik.

Nuk fajëson viktimën/të mbijetuarin; nuk bën viktimizimin dytësor të të mbijetuarve.

I sensibilizuar ndaj ështëjve të interseksionalizmit dhe ndikimit të dhunës tek personat e varur nga/familja e viktimës/të mbijetuarin.

Ofron platformë për zërat e viktimave/të mbijetuarëve pa cenuar dinjitetin dhe rrespektin, nëpërmjet kontributit të OJQ-ve, organizatave të shoqërisë civile.

Shfaq një jetë pas dhunës: shembuj shprese, inkurajimi dhe veprimi.

Merret me djemtë dhe burrat si partnerë në luftën kundër dhunës në të gjitha fazat e jetës.

Tabela 4: Parimet e përgjithshme të pranura të praktikës së mire mediatike në raportimin e DHBGJ-së

6. Komente

Pyetjet në vijim janë identifikuar si sfida të përgjithshme në periudhën e ardhshme:

- Niveli i ankesave publike ndaj mediave online duket të jetë më lartë se ai mediave „konvencionale“ gjegjësisht mediave të shkruara tradicionale dhe transmetuesve;
- Përfshirja e dhunës ndaj gazetarëve në kornizën e DHBGJ-së është thelbësore;
- Roli i mjedist sfidues duhet të merret parasysh kur raportohet për DHBGJ-në në mënyrë etike dhe duhet të jetë në përputhje me standardet e kërkuara.

Hapat e ardhshëm mund të përfshijnë:

- Nevoja e vazhdueshme për ngritjen e kapaciteteve dhe trajnimin e komunikuesve në mënyrë që të përmirësohet shkathtësia e raportimit;
- Nevoja për përmirësim të mëtejshëm të bashkëpunimit ndërsektorial si element kyç në luftën kundër DHBGJ-së;
- Është e nevojshme t'i kushtohet vëmendje e veçantë marrëdhnieve etnike dhe nacionalizmit në disa elemente të rrënjësura në aspektet gjeopolitike të rajonit që e inkurajojnë DHBGJ-në;

- Përdorimi i gjuhës specifike dhe koncize dhe i terminologjisë së standardizuar përmes publikimeve të autoriteteve dhe mediave për të rritur ndërgjegjësimin për DHBGJ-në;

Paketa thelbësore e rekomandimeve që fokusohet në sinergjinë ndërmjet palëve të interesuara në promovimin e një debati kombëtar të shëndetshëm dhe konstruktiv është:

- Zhvilli i një pakete mjetesh gjithëpërfshirëse për profesionistët e medias dhe industrinë e medias, duke përfshirë shërbimet online, për të ofruar trajnime bazë dhe udhëzime për paraqitjen dhe raportimin mbi DHBGJ-në dhe rolet gjinore;
- Zhvillimi i lidhjeve për bashkëpunim midis profesionistëve të nryshëm që punojnë në mënyrë specifike në DHBGJ-në ;
- Mbështet procesin e vetërregullimit dhe organin rregullator në përpjekje për të punuar në DHBGJ përmes praktikave të tyre dhe marrjen e masave për emërimin e grave në poste drejtuese.
- Bashkëpunimi ndërsektorial, duke përfshirë arsimin, universitetet, ata të cilët janë të parët në vendin e ngjarjes p.sh policia;
- Forcimi debatit publik duke shfaqur praktikat më të mira në formën e çmimeve të komunikimit public nga industria e medias ose profesionist të pavarur të medias për DHBGJ-në, si dhe duke vlerësuar subjektet dhe individët e tjerë për rolin e tyre në promovimin e një diskutimi të shëndetshëm rreth DHBGJ-së;
- Përmbledhje praktikash të mira dhe mësimesh të nxjerra, dhe vënien e tyre në dispozicion si mjete për edukimin e vazhdueshëm të publikut dhe medias.

7. Fjalorth

Terminologjia e përdorur në këtë doracak është në përputhje me Konventën e Stambolli në veçanti Neni 3.

Neni 3 – Definicionet për qëllime të Konventës:

a “dhuna ndaj grave kuptohet si shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi ndaj grave dhe i referohet të gjitha akteve të dhunës me bazë gjinore që shkaktojnë ose mund të rezultojnë në dëmtime ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike për gartë, duke përfshirë kërcënimet për akte të tilla, zhatje ose privim arbitrar të lirisë, qoftë në jetën publike apo private;

b “dhuna në familje” nënkupton të gjitha aktet e dhunës fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike që ndodhin brenda familjes ose familjes, gjegjësisht ndërmjet bashkëshortëve ose partnerëve të mëparshëm ose aktualë, pavarësisht nëse dhunuesi ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën ose jo;

v “gjini” I shënon rolet, sjelljet, aktivitetet dhe atributet e ndërhuara shoqërore që një shoqëri e caktuar I konsideron të përshatshme për gartë dhe burrat;

g “dhuna me bazë gjinore ndaj grave “ do të thotë dhunë ndaj një gruaje sepse është grua ose që e prek atë në mënyrë disproporcionale;

d “viktimë” është çdo person fizik I ekspozuar ndaj sjelljeve të përmendura në pikat a) dhe b) të këtij neni;

gj termi “gra” përfshin edhe vajzat nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç.

8. bibliografia

- Abbot Galvao, L (2015) Reporting on Violence against Women. A Case Study of Select News Media in Seven Countries in Latin America and the Caribbean. Inter-American Development Bank. <https://publications.iadb.org/publications/english/document/Reporting-on-Violence-against-Women-A-Case-Study-of-Select-News-Media-in-Seven-Countries-in-Latin-America-and-the-Caribbean.pdf>
- Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, Udhëzues për monitorimin e „gjuha e urrejtjes“, <https://avmu.mk/wp-content/uploads/2017/05/Vodic-za-monitoring-za-govorot-naomraza-Mak.pdf>
- Council of Europe (2011) Convention on preventing and combating violence against women and domestic violence (Istanbul Convention)
- Council of Europe Recommendation CM/Rec(2013)1 of the Committee of Ministers to member States on gender equality and media (Adopted by the Committee of Ministers on 10 July 2013 at the 1176th meeting of the Ministers' Deputies)
- Këshilli i Evropës, Rekomandim CM/Rec(2016a) nga Komiteti i Ministrave tek shtetet anëtare për mbrojtjen e gazetarisë dhe sigurinë e gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të medias
- Council of Europe (2016b) Internet Governance Strategy 2016-2019, Adopted at the 1252th Committee of Ministers' Deputies Meeting on 30 March 2016
- Council of Europe (2016c) Strategy for the Rights of the Child (2016-2021)
- Council of Europe (2016d) European Commission against Racism and Intolerance (ECRI) ECRI General Policy Recommendation No 15 on Combating Hate Speech
- Council of Europe (2016e) Factsheet Combating Sexist Hate Speech, Strasbourg
- Council of Europe (2016f) Seminar Combating Sexist Hate Speech, Report 10-12 February 2016, Strasbourg
- Council of Europe (2017) Media Regulatory Authorities and Hate Speech, Strasbourg
- Frauen Stad Wien (2008) Sensible Berichterstattung zum Thema Gewalt an Frauen, <https://www.wien.gv.at/menschen/frauen/pdf/sensible-berichterstattung.pdf>
- Geiger, Brigitte / Wolf, Birgit (2014): Geschlechtsbasierte Gewalt und die Rolle von Medien. In: Verein Autonome Österreichische Frauenhäuser (AÖF) (Hg.), Verantwortungsvolle Berichterstattung für ein gewaltfreies Leben, Anregungen zur medialen Prävention von Gewalt an Frauen und ihren Kindern, Wien. S. 8-26
- Hester, M and Lilley, SJ (2014) Eds. Preventing Violence against Women: Article 12 of the Istanbul Convention. A collection of papers on the Council of Europe Convention on preventing and combating violence against women and domestic violence, Strasbourg: Council of Europe
- House of Lords, House of Commons Joint Committee on Human Rights (2015) Violence against women and girls. Sixth Report of Session 2014-2015, HL Paper 106; HC 594. London: The Stationery Office Ltd
- Impe, Anne-Marie (2019) Reporting on violence against women and girls: a handbook for journalists, Paris: UNESCO

- Καραγιαννοπούλου, Χ., Μαράτου-Αλιπράντη, Λ., Φερέτη Ε. , Τσέλιου, Ε. (2015) Οδηγός Καταπολέμησης των Διακρίσεων λόγω Φύλου στα ΜΜΕ, Σύνδεσμος για τα Δικαιώματα της Γυναίκας https://www.jour.auth.gr/wp-content/uploads/2021/03/odigos_final_%CE%9C%CE%9C%CE%95.pdf
- Μοσχοβακου, Ν & Χατζηαντωνίου, Λ. (2018) Οδηγός προς τα Μέσα Μαζικής Επικοινωνίας για την εξάλειψη του σεξισμού και των έμφυλων διακρίσεων Αθήνα ΚΕΘΙ https://www.kethi.gr/sites/default/files/wp-content/uploads/2018/03/%CE%9F%CE%94%CE%97%CE%93%CE%9F%CE%A3_mme_publ.pdf
- NGO-Koalition GREVIO Schattenbericht (2016) Oesterreichischer NGO-Schattenbericht fuer GREVIO https://www.interventionsstelle-wien.at/download/?id=GREVIO-Schattenbericht_2016_de.pdf
- OSCE (2019) OSCE led survey on violence against women: North Macedonia. Well being and Safety of Women, Vienna: Austria ιστο така https://www.osce.org/files/f/documents/3/5/419264_1.pdf
- Pernegger, M (2020) Gewalt gegen Frauen. Jahresstudie 2019. Analyse der Berichterstattung ueber Gewaltdelikte an Frauen und die Rolle der Medien. Losenstein: Media Affairs <https://www.contentadmin.de/contentanlagen/contentdatei13591.pdf>
- Sarikakis, K. (2020) Technical report Workshop for the media regulatory authority and self-regulatory body for media ethics on regulation, self-regulation and monitoring of the application of reporting standards in gender-based violence cases in the media, TP-JUFREX2-NM-14Dec2020, Council of Europe
- Sutherland, G., Simons, M., and Blatchford, A. (2017) News Media and the primary prevention of violence against women and their children: emerging evidence, Insights and Lessons. Report prepared for Our Watch. Melbourne: RMIT University. <https://www.5050foundation.edu.au/assets/reports/documents/Emerging-evidence-guide-media.pdf>
- Sutherland, G., McCormack, A., Pirkis, J., Vaughan, C., Dunne-Breen, M., Eastal, P., & Holland, K. (2016). Media representations of violence against women and their children: Final report (ANROWS Horizons, 03/2016). Sydney: ANROWS.
- Tozija, F (2020) Women's safety and Gender-based violence in the Republic of North Macedonia, Front Public Health 8:33 <https://www.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC7047429/>
- Weber, A (2009) Manual on Hate Speech, Strasbourg: Council of Europe Publishing
- Wolf, B. (2014) Die Macht der Bilder: Ikonographie des Leidens oder Vision eines gewaltfreien Lebens? In: Verein Autonome Österreichische Frauenhäuser (AÖF) (Hg.), Verantwortungsvolle Berichterstattung für ein gewaltfreies Leben, Anregungen zur medialen Prävention von Gewalt an Frauen und ihren Kindern, Wien. pp. 28-34

MË SHUMË INFORMACIONE

Zyra programatike e Këshillit të Evropës në Shkup

Soravija Centar, Filip Vtori Makedonski nr. 3

1000 Shkup, Maqedonia Veriore

E-posta: coe.skopje@coe.int

<http://horizontal-facility-eu.coe.int>

 [jp.horizontal.facility](https://www.facebook.com/jp.horizontal.facility)

 [@CoE_EU_HF](https://twitter.com/CoE_EU_HF)

Ky publikim është përgatitur me fonde nga një program i përbashkët i Bashkimit Evropian dhe i Këshillit të Evropës. Qëndrimet e shprehura këtu nuk i pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e ndonjërit nga këto dy organizatave

„Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019-2022 I Bashkimit Evropian dhe dhe Këshilli Evropës dhe ua mundëson përdoruesëve t’i zbatojnë plane reformash në fushën e të drejtave të njeriut, sundimit të ligjit dhe demokracisë, dhe për t’u përafuar me standardet Evropiane, duke përfshirë, aty ku është e përshtatshme, brenda procesit të zgjerimit të BE-së. Ky program mbulon në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Sërbi, Turqi dhe Kosovë* dhe e zbaton Këshilli I Evropës nga maji i vitit 2019.

** Kjo shenjë nuk paragjykon pikëpamjet për statusin dhe është në përputhje me Rezoluta 1244 dhe Opinioni MKP për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.*

MKD

Советот на Европа е водечка организација за човековите права на континентот. Таа има 47 земји членки, вклучувајќи ги сите членки на Европската Унија. Сите земји членки на Советот на Европа се потписнички на Европската конвенција за човекови права, која претставува меѓународен договор за заштита на човековите права, демократијата и владеењето на правото. Европскиот суд за човекови права го надгледува спроведувањето на Конвенцијата во земјите членки.

www.coe.int

Земјите членки на Европската Унија одлучија да ги здружат своите знаења, ресурси и судбини. Заедно тие изградија зона на стабилност, демократија и одржлив развој, истовремено одржувајќи ја културната разноликост, толеранцијата и индивидуалните слободи. Европската Унија е посветена на спodelување на своите достигнувања и вредности со земји и народи вон своите граници.

www.europa.eu

Финансирано
од Европската Унија и
Советот на Европа



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Имплементирано
од Советот на Европа

